

**1. Zhvillimi profesional efektiv fillon me analizën e nevojave të nxwnësve.**

Nevojat e të mësuarit të nxwnësve duhet të ndikojnë direkt në atë (dijet dhe shprehitë ) që mësuesit do të mësojnë përmes zhvillimit profesional

**2. Zhvillimi profesional efektiv sfidon të menduarit e mësuesve si një pjesë fundamentale e ndryshimit të praktikës së mësimdhënies**

Zhvillimi profesional është i dukshëm në ndryshimet në praktikën por apo ashtu edhe në mënyrën e të menduarit. Duhet jo vetëm të bëhet dicka ndryshme por edhe të kuptohet pse një teknikë mësimdhënieje është më efektive se tjetra

**3. Zhvillimi profesional efektiv bazohet në vlerësimin e nevojave të shkollës, por edhe në vlerësimin e nevojave individuale të mësuesve.**

Nevojat individuale kanë të bëjnë si me me përmbajtjen e zhvillimit profesional por edhe me shqetësimet personale të mësuesve. Nevojat e mësuesve mund të ndikohen nga historia e tyre jetësore rrethanat personale dhe faza e jetës profesionale në një kohë të dhëne. Zhvillimi profesional në pëpruthje me këtë duhet të jetë i diferencuar. Ai përfshin mësuesit në hartimin e axhendës së zhvillimit të tyre profesional. Në të njëjtn kohë që zhvillimi profesional të ketë një impakt të gjerë duhet që të merren parasysh nevojat e ekipit (të mësuesve të tjerë në shkollë). Zhvillimi profesional priret të jetë më efektiv kur ai është pjesë e përpjekjeve të përgjithshme të shkollës , dhe jo kur është një aktivitet i izoluar që ka pak të bëjë me iniciativat dhe ndryshimet e tjera që ndodhin në rang shkolle. Zhvillimi profesional duhet të zhvillohet në një klimë kur nuk ka konflikt mes nevojave të mësuesit si individ dhe nevojave të shkollës (institucionit). Duhet krijuar një mjedis në shkollë ku individ kontriboun në zhvillimin e institucionit dhe insitucioni (eksperiencat bashkëpunuese) kontribuojnë në krijimin e një konteksti strategjik dhe plot kuptim në punën e mësuesit si individ

**4. Zhvillimi profesional efektiv përfshin lidhjen mes të mësuarit të bazuar në punë në shkollë me ekspertizën e jashtme.**

Vendi I punës është shumë i rëndësishëm për të mësuarit përmes eksperiencës përmes aktiviteteve dhe detyrave të caktuara. . Qëllimi është që të mësuarit profesional të realizohet përmes veprimit në situatë reale, me detyra konkrete dhe shpesh me komentet nga një mentor. Mësuesit vlerësojnë modelet e të mësuarit profesional që I lejojnë ata të eksperimentojnë në praktikën e tyre mësimore në klasë dhe ta përshtasin atë në dritën e refleksioneve dhe komenteve që marrin nga nxënësit, dhe kolegët e tyre. Aleancat e suksesshme të zhvillimit profesional kanë në themel të tyre tre parime: bashkëpunimin mes shkollave; bashkëpunimin gjatë kohës dhe bashkëpunimin me partnerët e jashtëm. Partnerët (ekspertët e jashtëm) duhet të jenë kompetentë me komentet e tyre.

Edhe pse është ifokusuar në shkollë, i drejtuar nga shkolla dhe i bazuar në shkollë, zhvillimi profesional ka nevojë që të përdorë ekspertizën e jashtme ku është e mundur.Kjo ekspertizë mund të sigurohet nga personi konkretisht, ose përmes të lexuarit dhe online dhe I ndihmon mësuesit të lidhin praktikën me teorinë. Ekspertizë e jashtë ndihmon shumë në stimulimin e një të menduari të ri.

**5. Zhvillimi profesional është i larmishëm, i pasur dhe i vazhduar.**

Përfshin modele të ndryshme me të cilat mësojnë më mirë të rriturit. Të mësuarit duhet të bazohet në atë që dinë më parë mësuesit. Përdor teknika konstruktiviste. Konstruksioni I dijes është eksperiencial dhmtë është një proces ndryshimi që përfshin zgjerimin, krijimin , modifikimin, përmiërsimin ristrukturimin dhe mohimin. Mësuesit kanë nevojë për një larmi aktivititesh të cilat mund të përputhen me preferncat e tyre dhe nevojave të vecanta që ata kanë. Mësuesit vënë në dukje se ata kanë nevojë më shumë për një zhvillimi profesional që fokusohet në mësimdhënien dhe mësimnxnësiën dhe në lëndë të vecanta Efekte të forta të zhvillimit profesional janë gjetur në raste kur aktivitetet I mësojnë mësuesit se si të japin mësim nnj përmbajtje specifike lëndore te nxënësit si të përdorin teknika specifike pedagogjike si të analizojnë punën e nxënësit etj Kualiteti I zhvillimit profesional lidhet me mundësitë e qëndrueshme në kohë që mësuesit të aplikojnë atë që kanë mësuar në praktikën e tyre mësimore gjatë një periudhë të shtrirë në kohë. ZHP nuk është një aktivitet i shkëputur, por dicka që është e qëndrueshme intensive dhe në thellësi. Aktivitete që nuk kanë koherencë kanë më pak impakt.

**6. Zhvillimi profesional efektiv përdor si mjet kryesor kërkimin shkencor për problemet e përditshme. (action research)**

Përfshirja në kërkim e stafit të shkollës për të investiguar problemet kyc në mësimdhënie dhe në mësimnxënie , nxjerrjen e gjetjeve dhe përdorimin e të dhënave në punën e tyre për të marrë vendime në lidhje me mësimdhënie. Kur mësuesit kanë një të kuptuar të thellë për nxënësit e tyre ata dinë se çfarë të bëjnë për të plotësuar nevojat e tyre. Krijimi i partnershipeve të strukturuar , bashkëpunuese mes shkollës dhe kërkuesve shkencorë ndihmon në rritjen e përfshirjes së mësuesve në kërkim shkencor dhe përdorimin e gjetjeve të studimeve në punën e tyre. Përkushtimi në kërkimin shkencor është një tipar i rëndësishëm i të mësuarit profesional sepse ai siguron fakte të cilat mund të përdoren për të ndryshuar praktikën mësimore dhe për të përmirësuar përparimin e nxënësve.

**7. Zhvillimi profesional efektiv promovohet fuqishëm përmes të mësuarit bashkëpunues dhe zhvillimit të praktikës së përbashkët.**

Mësuesit mund të mësojnë mirë ëprmes njëritjetrit. Ky është një mjet shumë i fuqishëm i zhvillimit profesional efektiv. Modele të fuqishme të mësuarit bashkëpunues përfshin mentorimin, çiftësimin e mësuesve, studimin e leksioneve, rrethet mësimore. Mësuesit që punëjnë në bashkëpunim me mësuesit nga shkollat e tjera rrisin mundësitë për të mësuar nga njëri tjetri. Të mësuarit bashkëpunues është me efektiv kur zhvillohet besimi.

**8. Zhvillimi profesional efektiv promovohet duke krijuar komunitete të të mësuarit profesional brenda dhe mes shkollave.**

**9. Zhvillimi profesional efektiv kërkon që lidhshipi të krijojë kushtet e nevojshme.**